

**VENDIM****Nr. 30, datë 13.6.2016**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET
NR. 39, DATË 16.10.2015, DHE NR. 1, DATË
4.2.2016, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e fondit për programin “Infrastrukturë vendore dhe rajonale”, si dhe për disa ndryshime në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 18, datë 19.11.2014, nr.5, datë 9.2.2015, dhe nr. 22, datë 8.5.2015”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhë vendimit nr. 1, datë 4.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të fondit për zhvillimin e rajoneve dhe kalendarit të programeve të

financimit, për vitin 2016”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar;
anëtar;

anëtar
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar



Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr.39, datë 16.10.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr.15, si më poshtë vijon, në tabelën 1, të këtij vendimi i anulohet financimi.

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
15	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i sheshit “Skënderbej”	1,014,543,261	202,908,652	405,817,304	405,817,304

Shënim:

1. Anulimi i financimit për këtë projekt, që nuk është prokuruar ende, bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban nr.3129/1 prot, datë 1.6.2016.
2. Vlera e financimit për vitin 2015, prej 202,908,652 lekësh, i shtohet portofolit të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi “Zhvillimi vendor dhe rajonal”, shtylla I, për vitin 2016. Ky fond të shpërndahet për financimin e projekteve të reja, të thirrjes së dytë, për vitin 2016, dhe/ose të projekteve në vazhdim, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale.
3. Totali i vlerës së projektit si dhe vlera e financimit për vitet 2015, 2016 dhe 2017, për tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.39, datë 16.10.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në lekë)
		TOTALI	4,365,403,906	643,094,589	2,885,810,553	836,498,765

4. Pika 15 e tabelës 1, të vendimit nr.39, datë 16.10.2015, shfuqizohet. Numri rendor i totalit të projekteve, në tabelën 1, të këtij vendimi ndryshon, nga 31 projekte në 30 projekte.

Tabela 2. Në tabelën 2, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 04.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, mbas rreshtit të katërt të tabelës, shtohet rreshti, si më poshtë vijon:

Thirrja	Data	Shtylla/Programi/Granti	Projekte	Vlera e grantit për thirrje
Thirrja III	Java e fundit e qershorit	Shtylla 1 – Programi “Zhvillimi i infrastrukturës vendore dhe rajonale - Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”	Drejtimet e thirrjes, masat dhe tipologjia e projekteve që do të financohen nga kjo thirrje, do të përcaktohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në mbledhjet vijuese.	Vlera e grantit për këtë thirrje do të përcaktohet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në mbledhjet vijuese